



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 49

Tiranë – E hënë, 24 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9844, datë 27.11.2018	
Me objekt: Mbyllje e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Global Foods në administrim”	3



VENDIM

Nr. 9844, datë 27.11.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:***Gjyqtar: ERVIN POLLOZHANI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Lusjana Fezollari**, sot në datën **27.11.2018**, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike, çështjen civile-tregtare me **nr. 194 Regj. Themeltar**, që i përket:

KËRKUES: SUBJEKTI HUAMARRËS “GLOBAL FOODS NË ADMINISTRIM”, e përfaqësuar nga znj. Lindita Kikino, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 12 licence, me cilësinë e administratores së falimentimit, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati Sara-El, shk. 1/1, Tiranë.

OBJEKTI: Mbyllje e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Global Foods në Administrim”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, neni 163 i tij.

Gjykata pasi administroi provat, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të administratores së falimentimit Lindita Kikino, e cila kërkoi mbylljen e procedurës së falimentimit për shkak të shpërndarjes së të ardhurave kreditorëve të falimentimit, si dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VËREN:

Se, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 22.8.1997, “Për caktimin e personave juridikë që do t’i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997, me urdhër të ministrit të Financave nr. 8077, datë 18.5.2012, bazuar në ligjin nr. 41, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, subjekti “Global Foods” është marrë në administrim nga administratori z. Bajram Malaj. Ky subjekt (shoqëria “Global Foods”) sipas pretendimeve të kërkuarit, e ka mbaruar procesin e administrimit dhe për këtë arsye, në bazë të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, kërkuari i është

drejtuar gjykatës duke kërkuar shpalljen e falimentimit të saj.

Ky subjekt rezultoi të ketë ushtruar veprimtarinë e huamarrjes publike me qëllim rikthimin e vlerave monetare huamarrësve përkundrejt interesave. Vënia e këtij subjekti nën administrimin dhe kontrollin shtetëror kishte për qëllim verifikimin paraprakisht të gjendjes financiare, administrimin e pasurisë dhe kthimin e vlerave monetare huamarrësve.

Pas një procesi të gjatë të administrimit shtetëror sipas akteve ligjore dhe nënligjore specifike, shteti shqiptar përmes miratimit të ligjit nr. 41/2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” vendosi shpërndarjen e Grupit Mbikëqyrës të subjekteve të kontrollit dhe dorëzimin e gjithë dokumentacionit arkivor dhe aseteve financiare personit të ngarkuar nga Ministria e Financave. Njëkohësisht u vendos emërimi i një administratori për administrimin e mëtejshëm të subjekteve të kontrollit deri në likuidimin e plotë të tyre, duke akorduar dhe një buxhet limit për mbulimin e shpenzimeve të administrimit dhe likuidimit.

Administratori i emëruar nga ministri i Financave detyrohej të evidentonte gjendjen reale të pasurive të shoqërisë dhe të paraqiste në gjykatë kërkesat për çeljen e procedurave të falimentimit në rast se ekzistonin kushtet ligjore.

Sa më sipër sanksionohet në nenet 1, 3 dhe 4, të ligjit nr. 41/2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”: “*Grupi Mbikëqyrës i emëruar dhe që ka funksionuar në përputhje me ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, shpërndahet (neni 1).*”

“Për administrimin e mëtejshëm të subjekteve të kontrollit deri në likuidimin e plotë të tyre ministri i Financave emëron një administrator me një staf ndihmës, si dhe përcakton një limit buxhetor vjetor nga të ardhurat e subjektit të kontrollit për mbulimin e shpenzimeve të administrimit/likuidimit” (neni 3).

Administratori brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet: a) t’i raportojë ministrit të Financave gjendjen reale të pasurive të shoqërisë, subjekte të kontrollit, nëpërmjet një raporti të hollësishëm, të shoqëruar me pasqyrat financiare të vitit më të fundit ushtrimor për secilën shoqëri



administrimi; b) të depozitojë në gjykatë kërkesat për faliment të të gjitha shoqërive, subjekte të kontrollit të marra në administrim...” (neni 4).

Referuar kuadrit të mësipërm ligjor administratori i subjekti huamarrës “Global Foods në administrim” (z. Bajram Malaj) ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për çeljen e procedurës së falimentimit për këtë subjekt kontrolli.

Paraprakisht gjykata duke marrë në konsideratë kërkesat procedurale të nenit 16 të K. Pr. Civile, i cili sanksionon se: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj” arriti në konkluzionin se, kuadri i posaçëm ligjor që ka sanksionuar fillimin e procedurave të falimentimit të subjekteve huamarrëse përmes paraqitjes së kërkesave në gjykatë nuk ka përcaktuar procedura të veçanta për këtë proces, çka orienton vendimmarrjen gjyqësore në zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008 (ligji i kohës kur është paraqitur kërkesa).

Sa më sipër, pasi ka administruar provat e paraqitura në gjykim nga administratori i subjektit “Global Foods në administrim”, në raport me pasuritë dhe detyrimet e këtij subjekti kundrejt të tretëve (kreditorëve) gjykata mori në shqyrtim dispozitat e mëposhtme të ligjit “Për falimentimin”:

Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: 1. *Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.* 2. *Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryben pagesat...* 4. *Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë..”*

Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) sanksionon: “1. *Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore kur rezultojnë një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare.*

Neni 15 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionerët e shoqërisë ndaj të cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj duhet të paraqesin: a) listën e pasurive dhe të ardhurave së bashku me një deklaratë ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur ose është ngarkuar me barrë si i tillë; b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre;

2. *Dokumentacioni duhet të përmbajë dhe një deklaratë përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë”.*

Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) sanksionon: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit”.

Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit.* 2. *Vendimi përhapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; c) të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës.* 4. *Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit”.*

Në analizë të kushteve ligjore që determinojnë çeljen e procedurës së falimentimit gjykata vlerësoi si më poshtë vijon:

Procedura e falimentimit në thelb përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt në rast se konkludohet se një veprim i tillë është i mundur.



Fillimi në rrugë gjyqësore i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit, i konceptuar si: *a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim ose; b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.*

Legjitimitimin aktiv për iniciimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzon kreditori, debitori, sikurse rezulton në rastin objekt gjykimi, si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare.

Në rastin konkret, duke qenë se pala kërkuese është vetë përfaqësuesi ligjor i subjektit të së drejtës në gjendje të paaftësisë paguese, gjykata çmon se përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie, legjitimohet t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar shpalljen e falimentimit të saj.

Pala kërkuese pretendoi në gjykim se shoqëria “Global-Foods” shoqëri në administrim, ishte e përfshirë në administrim si pjesë e shoqërive huamarrëse që kanë marrë hua nga publiku i gjerë. Kjo shoqëri ka kaluar në administrim me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 22.8.1997, “Për caktimin e personave juridikë që do t'i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997. Me urdhër të ministrit të Financave nr. 8077, datë 18.5.2012, bazuar në ligjin nr. 41, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, subjekti është marrë në administrim nga administratori Bajram Malaj. Subjektit juridik i ishte kryer procesi i administrimit nga administratori i shoqërive huamarrëse, ishte në gjendjen e paaftësisë paguese e në këto kushte, referuar dispozitës së sipërcituar, kjo shoqëri duhet të kalonte në falimentim.

Situata e shoqërisë huamarrëse “Global Foods” shoqëri në administrim është jo e zakonshme, provuar kjo me faktin se kjo shoqëri ka pasur si veprimtari të sajën marrjen hua nga publiku i gjerë. Në këto kushte, edhe detyrimet e saj si rezultat i drejtpërdrejt i kësaj veprimtarie, janë ndaj publikut të gjerë. Sipas bilancit të paraqitur nga shoqëria, detyrimi i përket pjesës së palikuiduar të kreditorëve, sipas koeficientit të përcaktuar nga VKM-ja nr. 163, datë 30.4.2000

dhe ky detyrim është në shumën 1. 150. 793 lekë. Likuiditeti që shoqëria zotëron në datën 31.12.2012 sipas ekspertës së caktuar nga gjykata, është i mjaftueshëm për të shlyer detyrimin ndaj kreditorëve të mbetur.

Një fakt i tillë provohet me anë të akteve shkresore bilance financiare viti 2011 dhe 2012, si dhe listës së kreditorëve, të administruara në gjykim me cilësinë e provës.

Me qëllim hetimin e ekzistencës së shkakut të falimentimit gjykata caktoi në cilësinë e administratorës së përkohshme të falimentimit znj. Lindita Kikino.

Administratorja e përkohshme, pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin e paraqitur në Gjykatë nga pala kërkuese, si dhe me detyrat e lëna nga gjykata, paraqiti një raport me datë 15.10.2013.

Në këtë raport të administratorës së përkohshme të falimentimit konkludohet sa më poshtë vijon se:

Referuar shifrave të pasqyruara në bilancin e shoqërisë, detyrimet e subjektit janë më të mëdha se sa të drejtat e saj. Ndryshimi i vetëm në rastin konkret është se pavarësisht shifrës së detyrimeve që është e përcaktuar në bilance, këto detyrime nuk shlyhen më, pasi shlyerja e tyre është bërë në zbatim të VKM-së nr. 163, datë 30.4.2000. Sipas përfundimeve të arritura nga ekspertja, shoqëria huamarrëse nuk është e mbingarkuar me borxhe, pasi detyrimi i mbetur për një pjesë të kreditorëve, arrin të përballohet nga likuiditeti që shoqëria zotëron në fund të periudhës 31.12.2012. Kjo shoqëri nuk ka asete të saj sepse ato janë shitur në zbatim të ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012 dhe ka 22 kreditorë të palikuiduar.

Sipas ekspertës kontabël, shoqëria “Global-Foods” shoqëri në administrim, nuk ka nevojë as për vlerësim asetesh, as për sigurim të pasurisë dhe as për shitje të tyre. Shpenzimet e falimentimit për këtë shoqëri janë minimale dhe likuiditeti që ajo zotëron, i përballon këto shpenzime.

Në këto kushte, pretendimi i ngritur nga pala kërkuese lidhur me plotësimin e kushteve të falimentimit për këtë shoqëri, është i mbështetur në ligj e në prova sepse:

-Përcaktimet e nenit 13 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, nuk



merren parasysh për shoqërinë “Global Foods” në administrim, sepse falimentimi i shoqërisë ka ndodhur në fakt dhe procedura e falimentimit që do të kryhet, është në zbatim të ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012, neni 4, pika b e tij.

Neni 4 i ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” parashikon se:

Administratori, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet:

a) t’i raportojë ministrit të Financave gjendjen reale të pasurive të shoqërive, subjekte të kontrollit, nëpërmjet një raporti të hollësishëm, të shoqëruar me pasqyrat financiare të vitit më të fundit ushtrimor për secilën shoqëri nën administrim;

b) të depozitojë në gjykatë kërkesat për faliment të të gjitha shoqërive, subjekte të kontrollit, të marra nën administrim;

c) të përgatisë dokumentacionin për shitje të të gjitha asetëve të paluajtshme dhe ta dërgojë në njësinë që merret me administrimin dhe shitjen e pronave pranë Ministrisë së Financave.

Në lidhje me verifikimin e faktit nëse pasuritë e shoqërisë mbulojnë shpenzimet e falimentimit (të përcaktuara si të tilla në nenin 37, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”), administratorja e përkohshme vëren se referuar gjendjes së likuiditetit të shoqërisë dhe mjetet monetare që kjo shoqëri zotëron, shpenzimet e falimentimit janë minimale dhe përballohen nga ky likuiditet.

Duke qenë se kërkesa për falimentimin e shoqërisë “Global-Foods” është mbështetur në ligjin nr. 41/2012, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, si dhe referuar faktit se kriteret e këtij ligji rezultojnë të jenë plotësuar për kërkesin në këtë gjykim, gjykata ka çmuar se kërkesa e paraqitur është e mbështetur në ligj e në prova e si e tillë duhet pranuar, duke vendosur hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Global-Foods” shoqëri në administrim.

Në këtë mënyrë pasi konfirmoi ekzistencën e shkaqeve ligjore për çeljen e procedurës së falimentimit gjykata me vendimin nr. 10615, datë 25.10.2013, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Global-Foods” shoqëri në administrim, regjistruar me vendimin nr. 15992, datë 11.6.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT nr. J62208003U, me përfaqësues ligjor Gani Shehu.

3. Emërimin si administratore e përkohshme e falimentimit e ekspertës kontabël të autorizuar znj. Lindita Kikino, me nr. licence 12, datë 15 tetor 2012.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, të gjitha pretendimet e tyre tek administratorja e falimentimit duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë mbi pasuritë e personit të tretë në këtë gjykim.

5. Një kopje e këtij vendimi, duhet t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, të publikohet në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë palës kërkuese në këtë gjykim dhe duhet të regjistrohet në të gjitha regjistrat e tjerë ku janë të regjistruara të drejtat e debitorit shoqërisë “Global-Foods” shoqëri në administrim.

Referuar nenit 26/4, të ligjit “Për falimentimin” gjykata ka çmuar më tej se administrator i falimentimit për kërkesin do të caktohet ekspertja kontabël e autorizuar Lindita Kikino, në mbështetje të nenit 43 të ligjit të sipërcituar.

Në respektim të vijimësisë së procedurës së falimentimit për sa u përket përcaktimeve ligjore të bëra, rezulton e provuar se, pavarësisht disponimeve të bëra në vendimin nr. 10615, datë 25.10.2013, lidhur si me mbledhjen për raportim ashtu dhe me mbledhjen për verifikim, një gjë e tillë për këtë shoqëri dhe sipas shpjegimeve të administratorës së falimentimit nuk ka ndodhur për shkak se kreditorët e shoqërisë në administrim, si dhe vlerat e kredisë së tyre u morën të mirëqenë sipas listës së paraqitur nga z. Bajram Malaj, administrator i shoqërive huamarrëse në administrim. Po kështu nuk u arrit të krijohej as Komiteti i Kreditorëve.

Nga dokumentet e depozituara në gjykatë ndodhej lista prej 21 kreditorësh, listë që i referohej gjendjes së tyre në datën 1.12.2008. Në listën e depozituar në gjykatë përveç të dhënave emër, mbiemër, shumat përkatëse, numri i kontratës, nuk kishte asnjë të dhënë tjetër. Duke qenë se nuk disponohej asnjë adresë kontakti për



këta kreditorë, nuk u bë e mundur lajmërimi i tyre veç e veç. Shuma për çdo kreditor ishte e përcaktuar pas shpërndarjes së kryer sipas VKM-së nr. 163, datë 13.4.2000 “Për shpërndarjen me koeficient pjesor të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë Global-Foods sh.p.k. në administrim”.

Meqenëse nuk kishte asnjë informacion për kreditorët, njoftimi i tyre ishte i pamundur, për rrjedhojë nuk është caktuar komitet kreditorësh, nuk u zhvillua mbledhje kreditorësh dhe nuk u paraqitën pretendimet nga këta kreditorë. Si listë përfundimtare pretendimesh u mor lista që u administrua nga gjykata në momentin e depozitimit të kërkesës nga shoqëria mbikëqyrëse e shoqërive që kishin marrë hua nga publiku i gjerë.

Për njoftimin e 21 kreditorë sipas listës, për të tërhequr shumat respektive janë bërë njoftime në shtypin e përditshëm “Gazeta Telegraf”, 3 herë, për 3 ditë rresht, në periudha të ndryshme, konkretisht në datat 11, 12, 15 korrik 2014; 15, 16, 17 tetor 2014; 5, 6, 7 shkurt 2015.

Në fillimin e procedurës së falimentit, pas njoftimeve të bëra, Banka Credins ku ndodhej e depozituar shuma për efekt shpërndarje të kreditorëve, njoftoi që një nga kreditorët e listës përfundimtare e kishte marrë shumën që i takonte dhe kreditori ishte znj. Zhaneta Trosha.

Gjatë procesit të falimentit u realizua njohja nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të 4 kreditorë të rinj dhe konkretisht: z. Baftjar Zylali, z. Dalip Pirjasi, z. Halil Kollcaku dhe z. Shkëlqim Suli.

Gjatë periudhës janë bërë tërheqje nga 6 kreditorë, 4 të rinj të njohur gjatë procedurës së falimentit dhe 2 nga lista ekzistuese, çka bëri që lista nga 21 kreditorë të mbetej në 19 kreditorë.

Për të bërë të mundur njoftimin e kreditorëve, duke qenë se nuk ekzistonin adresa për kreditorët e shoqërisë, u mundësua komunikimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për të gjetur adresat e kreditorëve duke u paraqitur nga kjo e fundit me shkresën nr. 471/1 prot., datë 9.7.2015 informacioni për adresën e 7 kreditorëve, të cilëve ju bë njoftimi individual dhe konkretisht: Fatos Zyberi, Gëzim Mucogllava, Hysmet Elmazaj, Pandeli Zahara, Sazan Katillari, Sokol Hermeraj dhe Ylli Hasanbelliu. Por edhe për këta 7 kreditorë të

cilëve adresa ju bë e mundur nga komunikimi me Drejtorinë e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Posta Shqiptare ktheu 4 njoftime për adresë të shkurtër, pra dhe adresat e vëna në dispozicion nga DPGJ Civile nuk rezultuan të plota.

Gjithashtu për të realizuar njoftimin e kreditorëve, duke qenë se shumica e tyre ishin nga Qarku i Beratit, u bë njoftimi në median lokale “TV Onufri” media audio-vizive e qarkut. Pas njoftimit në TV Onufri u bë e mundur likuidimi edhe i 5 kreditorë të tjerë, të cilët ishin: Agim Toska, Gëzim Mucogllava, Myrteza Mucolli, Pandeli Zahara dhe Sadije Arapi.

Ndërkohë që një problem i kosntatuar ishte fakti që rezultuan të ishin 5 kreditorë me të njëjtin emër dhe mbiemër që e bënte të pamundur identifikimin e tyre. Për këtë qëllim u kërkuar përsëri informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për këtë kategori kreditorësh, ku u bë e mundur vënia në dispozicion e adresave për 2 prej tyre, me shkresën nr. 6864/1 prot., datë 24.10.2016, që janë shtetasit: Kastriot Nako dhe Ylli Dyrmishi. Për këta 2 kreditorë u bë njoftimi i veçantë por deri në momentin e raportit përfundimtar, si dhe deri në mbylljen e kësaj procedure, nuk pati asnjë reagim nga ana e tyre.

Janë zhvilluar disa seanca pranë gjykatës për të dhënë informacion për ecurinë e procedurës së falimentit dhe problematikat e dala prej saj, ku në komunikimin e fundit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, u desh ndërhyrja e gjykatës për të bërë të mundur dhënien e informacionit për kreditorët që ishin me të njëjtin emër dhe mbiemër.

Korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ishte faza e fundit me të cilën të mund të njoftoheshin efektivisht kreditorët pasi sa më sipër janë ezauruar të gjitha opsionet e mundshme të komunikimit me ta.

Me vendimin nr. 268 akti, datë 3.3.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë miratoi shpërblimin për administratoren e falimentit Lindita Kikino në masën 241. 210 lekë dhe rimbursimin e shpenzimeve të kryera për procedurën e falimentit në shumën 4. 040 lekë në bazë të neneve 50, 51 dhe 52, të ligjit “Për falimentimin” dhe VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe shpenzimet e administratorit të



falimentimit”: “1. *Administratorja e falimentimit ka të drejtën e shpërblimit për punën e kryer dhe rimbursimin e shpenzimeve të bëra gjatë përmbushjes së detyrës. 2. Masa e zakonshme e shpërblimit vendoset në bazë të vlerës së masës së falimentimit në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit. 3. Masa e zakonshme e shpërblimit vlerësohet në varësi të vëllimit dhe shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorës së falimentimit” (neni 50) “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton me vendim shpërblimin dhe shpenzimet që duhet t’i rimbursohen administratorit të falimentimit.*

Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit më përjashtim të shumës së parashikuar duhet të shpallet publikisht dhe t’i njoftohet personalisht administratorës së falimentimit, debitorit, anëtarëve të komitetit të kreditorëve nëse është emëruar prej tyre. Në vendimin e seksionit tregtar të rrethit të shpallur publikisht duhet të vibet në dukje se teksti i plotë i vendimit gjendet në sekretarinë e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit... (neni 51).

Shpërblimi i administratorës së falimentit është llogaritur në vlerën 10% të masës së falimentimit sipas VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007. Ndërsa shpenzimet e masës së falimentimit sipas zërave respektivë të pasqyruara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vërtetohen nga faturat tatimore të administruara në dosjen gjyqësore.

Nga moment i miratimit të shpenzimeve e më pas nuk pati asnjë interesim nga kreditorët e kësaj shoqërie. Përfundimisht lista e kreditorëve të pa likuiduar, përbëhet nga 14 kreditorë në shumën totale 786. 905 lekë konkretisht: Ardian CAKALLI 78.750 lekë; Fatos ZYBERI 43.050 lekë; Gani DERVANI 31.500 lekë; Hysmet ELMAZAJ 31.500 lekë; Kaliopi GJEZA 31.500 lekë; Madile KUBE 31.500 lekë; Mexhit FENO 35.875 lekë; Kastriot NAKO 58.590 lekë; Rrape VANI 143.500 lekë; Sali TOSKA 31.500 lekë; Skënder QEVANI 57.400 lekë; Sokol HERMERAJ 149.240 lekë; Ylli HASANBELLI 31.500 lekë; Ylli DYRMISHI 31.500 lekë.

Faza e fundit në këtë procedurë falimentimi ishte procedura e kalimit të shumës që ndodhej në llogarinë e shoqërisë në një llogari të thesarit pranë Ministrisë së Financave, kjo në referim të nenin 7 të ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012, “Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” ku thuhet se: “fondet që janë të depozituara në bankën e nivelit të dytë, e cila po realizon pagesat e kreditorëve të shoqërive, do të

jenë në dispozicion të këtyre të fundit për një periudhë 5-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas këtij afati, të gjitha mjetet monetare të patërhequra do të depozitohen në një llogari të veçantë, të hapur nga Ministria e Financave, në një bankë të nivelit të dytë”. Rezulton se në muajin prill të vitit 2017 është plotësuar afati 5-vjeçar sipas ligjit nr. 41/2012, datë 12.4.2012, prandaj dhe duhej bërë kalimi në një llogari të veçantë të hapur nga Ministria e Financës.

Sa më sipër parashtrohet në raportin e administratorës së falimentimit, të cilit i bashkëlidhen informacionet e përcjella nga Banka Credins sh.a. Administratorja e falimentimit i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për hapjen e një llogarie bankare për depozitim të shumave të patërhequra nga kreditorët. Me shkresën nr. 11917/1 prot., datë 15.10.2018, të ministrit të Financave është miratuar hapja e llogarisë në lekë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 17.10.2018, vendosi të pranojë kërkesën e administratorës së falimentimit dhe të urdhërojë depozitim pranë Bankës Credins sh.a., në nr. e llogarisë 00000589004 të çelur në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të shumës së patërhequr nga kreditorët e subjektit në falimentim Global Foods” në shumën 564, 703. 11 lekë në bazë të nenit 161, të ligjit “Për falimentimin”: “Shumat që janë mbajtur gjatë shpërndarjes përfundimtare depozitohen në një agjenci të përshtatshme me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, për llogari të palëve pjesëmarrëse”.

Në datën 23.10.2018 është bërë kalimi i shumës 564. 703, 11 lekë në llogarinë me numër 1127489 pranë Credins Bank.

Me shpërndarjen e masës së falimentimit dhe depozitim të shumave të patërhequra në Bankën Credins sh.a. administratorja e falimentimit paraqiti një raport përfundimtar në lidhje me llogaritë e procedurës së falimentimit, ku u paraqit njëkohësisht dhe mandati që vërteton depozitim në bankë të shumave të patërhequra nga kreditorët, si dhe gjithë akteve të tjera të mbajtura gjatë kësaj faze të procedurës të cilat u administruan si të tilla.

Diskutimi i llogarive përfundimtare të procedurës së falimentimit në mbledhjen përfundimtare të kreditorëve bazohet në nenin 160 të ligjit “Për falimentimin”: “1. Kur jepet pëlqimi për shpërndarjen përfundimtare seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton afatin për një mbledhje përfundimtare të

kreditorëve. Gjatë mbledhjes: a) diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit; b) vërejtje ndaj listës përfundimtare; c) vendosin për sendet që janë pjesë e masës së falimentit dhe të papërshtatshme për shitje”.

Shpërndarja e masës së falimentimit dhe mbajtja e mbledhjes përfundimtare të kreditorëve përbën momentin fundor juridik dhe financiar të procedurës së falimentimit, e cila pasohet nga vendimi gjyqësor për mbylljen e procedurës së falimentimit konform nenit 163, të ligjit “Për falimentimin”: *“Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht”.*

Procesi i falimentimit i subjektit huamarrës Global Foods konkludoi në formën e likuidimit, ku e vetmja pasuri në trajtën e likuiditeteve u shpërnda mes kreditorëve, nga të cilët një pjesë e tyre paraqiten interes për tërheqjen e vlerave monetare takuese.

Në këtë mënyrë i gjithë operacioni juridik dhe financiar i falimentimit i realizuar në përputhje me dispozitat e ligjit “Për falimentimin”, nën drejtimin e administratorit të falimentimit dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës, realizoi qëllimin final të sanksionuar në nenin 1 të ligjit shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave kreditorëve.

Në përfundim gjykata vendosi mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global Foods” në administrim.

PËR KËTO ARSYE,

Në bazë të neneve 126, 306–309 të K. Pr. Civile dhe nenit 163, të ligjit “Për falimentimin”, gjykata,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim.

2. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim t’i komunikohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim t’i komunikohet administratores së falimentimit Lindita Kikino dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

4. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim në buletin zyrtar të njoftimeve publike.

5. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

8. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të subjektit huamarrës “Global-Foods” në administrim në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentin.

10. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimit.

11. U shpall sot, në datën 27.11.2018, Tiranë.

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017